



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.184

dhjetor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9853 datë 26.12.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”	5789
Ligj nr.9854 datë 26.12.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar	5793
Ligj nr.9855 datë 26.12.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”	5796
Ligj nr.9856 datë 26.12.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar	5799
Ligj nr.9857 datë 26.12.2007	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.2, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar”	5800
Ligj nr.9858 datë 27.12.2007	Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë..	5801

LIGJ
Nr.9853, datë 26.12.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9655, DATË 11.12.2006 “PËR
AKADEMINË E SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pikat 1 e 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5
Anëtarët e Akademisë

1. Akademia ka në përbërje anëtarë të rregullt, anëtarë të përhershëm, anëtarë të asociuar dhe anëtarë nderi.
2. Anëtarët e rregullt të Akademisë mbajnë titullin “Akademik” dhe të tillë janë 30 veta. Në këtë grup përfshihen edhe anëtarët e përhershëm të Akademisë dhe të tillë janë deri në 10 veta.
3. Anëtarët e asociuar të Akademisë mbajnë titullin “Akademik i asociuar” dhe të tillë janë 15 veta.
4. Anëtarë nderi të Akademisë janë personalitete të njohura të vendeve të tjera. Numri i tyre përcaktohet në statutin e Akademisë, por ky numër nuk e kalon atë të anëtarëve të rregullt të Asamblesë së Akademisë.”.

Neni 2

Në nenin 6, pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Anëtarë të përhershëm të Akademisë zgjidhen akademikët, që kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe kanë një kontribut të shquar, të vlerësuar gjerësisht, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.”.

Neni 3

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1
Përfundimi i anëtarësisë në Akademi dhe plotësimi i vendeve vakante

1. Statusi i anëtarit të rregullt, atij të asociuar dhe i çdo funksioni tjetër drejtues, të lidhur me këto funksione, në zbatim të neneve 9 dhe 10 të këtij ligji, përfundon kur anëtari:
 - a) mbush moshën 75 vjeç;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) zgjidhet apo emërohet në funksione drejtuese në parti politike apo organe kushtetuese;
 - ç) deklarohet i paaftë për të vepruar, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një krimi;
 - dh) shkarkohet me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Asamblesë për akte e sjellje, që

cenojnë rëndë figurën e anëtarit të Akademisë;

e) ndërron jetë.

2. Statusi i anëtarit të përhershëm përfundon kur vërtetohet një nga rastet e mësipërme, me përjashtim të atij të parashikuar në shkronjën “a”.

3. Statusi i anëtarit të nderit përfundon kur vërtetohet një nga rastet e mësipërme, me përjashtim të atyre të parashikuara në shkronjat “a” dhe “c”.

4. Procedurat për plotësimin e vendit vakant, të krijuar për shkak të përfundimit të funksionit, sipas pikës 1 të këtij neni, fillojnë jo më vonë se dy muaj para përfundimit të funksionit, sipas shkronjës “a” dhe jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tij, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të pikës 1 të këtij neni.”.

Neni 4

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Shpërblimi i anëtarëve

1. Pranimi në Akademi si anëtar i rregullt, i përhershëm apo i asociuar nuk nënkupton një vend pune me kohë të plotë dhe të pagueshëm në Akademi.

2. Anëtarët e Akademisë, që kanë vende pune me kohë të plotë dhe të pagueshme në Akademi, janë anëtarët e kryesisë dhe drejtuesit e seksioneve.

3. Nga buxheti i Akademisë paguhet shpërblimi për titullin “Akademik” dhe mbështetet veprimtaria akademike e anëtarëve të rregullt, të përhershëm, të asociuar dhe anëtarëve të nderit, që nga momenti i pranimi në Akademi deri në ndërprerjen e anëtarësisë në të për shkaqet e parashikuara në nenin 6/1 shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”.

4. Anëtarët e rregullt të Akademisë, me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, që janë në marrëdhënie pune, krahas pagës, sipas vendit të punës, përfitojnë edhe shpërblim mujor për titullin “Akademik” në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ata, krahas pensionit që u takon si profesor, marrin edhe shpërblimin për titullin “Akademik”.”.

Neni 5

Neni 8 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 10 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Asambleja është organi më i lartë drejtues i Akademisë dhe përbëhet nga anëtarët e rregullt, anëtarët e përhershëm dhe anëtarët e asociuar të Akademisë.”.

Neni 7

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Mënyra e zgjedhjes së kryesisë

1. Kryetari i Akademisë përzgjidhet drejtpërdrejt me votim të fshehtë nga asambleja, nga radhët e anëtarëve të rregullt ose të përhershëm. Kryetar zgjidhet kandidati, i cili merr më shumë se gjysmën

e votave të të gjithë anëtarëve të asamblesë. Kryetari i zgjedhur nga asambleja emërohet nga Presidenti i Republikës.

2. Zëvendëskryetari, Sekretari Shkencor dhe drejtuesit e seksioneve përzgjidhen drejtpërdrejt me votim të fshehtë nga asambleja, nga radhët e anëtarëve të rregullt, të përhershëm ose të asociuar, sipas procedurave të përcaktuara në Statutin e Akademisë.

3. Kohëzgjatja e mandatit të Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit është 4 vjet, ndërsa e Sekretarit Shkencor dhe e drejtuesve të seksioneve është 5 vjet. Në çdo rast, kohëzgjatja e mandatit të Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe Sekretarit Shkencor nuk kalon kohëzgjatjen e statusit të anëtarit të rregullt ose të asociuar, në përputhje me nenin 6/1 të këtij ligji.

4. Kryetari, Zëvendëskryetari, Sekretari Shkencor dhe drejtuesit e seksioneve mund të zgjidhen në të njëjtin funksion për dy mandate, por jo radhazi.”.

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 8

Riorganizimi i Akademisë

1. Riorganizimi i Akademisë kalon në një periudhë kalimtare, e cila zgjat deri një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Gjatë periudhës kalimtare përgatiten kushtet për zgjedhjen e organeve dhe autoriteteve të reja drejtuese të Akademisë.

3. Riorganizimi i Akademisë drejtohet nga Komiteti i Reformimit të Akademisë së Shkencave (KRASH), krijuar me urdhër të Kryeministrit, sipas nenit 9 të këtij ligji.

4. Drejtimi veprimtarisë së Akademisë gjatë periudhës kalimtare, kryhet nga Kryesia e Përkohshme e Akademisë (KPA).

5. Veprimtaria e KRASH-it dhe KPA-së mbaron në ditën e emërimit të Kryetarit të Akademisë nga Presidenti i Republikës, sipas pikës 1 të nenit 11 të këtij ligji.

Neni 9

Komiteti i Reformimit të Akademisë

1. Komiteti i Reformimit të Akademisë kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe ka në përbërjen e tij si anëtarë:

- Ministrin e Arsimit dhe Shkencës;
- dy anëtarë të Asamblesë ekzistuese të Akademisë, të cilët e ruajnë anëtarësinë në akademi edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe kanë stazhin më të gjatë në Akademi;
- një anëtar ekspert i Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

2. Komiteti ka të drejtë të angazhojë për probleme të veçanta të reformës ekspertë shqiptarë dhe të huaj.

Neni 10

Detyrat e Komitetit të Reformimit të Akademisë

KRASH-i, në bashkëpunim me Kryesinë e Përkohshme të Akademisë, realizon këto detyra:

a) propozon përbërjen e Komisionit Përzgjedhës (KP) të anëtarëve të rinj të Asamblesë së Akademisë;

b) shpall vendet vakante të anëtarëve të Asamblesë së Akademisë, sipas fushave të shkencës, në bazë të propozimit të Komisionit Përzgjedhës;

c) shpall numrin fillestar të anëtarëve të përhershëm të Akademisë;

ç) shpall kriteret, që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë të rregullt dhe të asociuar të Akademisë, në bazë të propozimit të bërë nga Komisioni Përzgjedhës;

d) mbikëqyr procedurat e konkurrimit për vendet vakante;

dh) mbikëqyr procesin e zgjedhjes së organeve dhe autoriteteve drejtuese të Akademisë, në përputhje me këtë ligj dhe Statutin e Akademisë.

Neni 11
Kryesia e Përkohshme e Akademisë

1. Kryesia e Përkohshme e Akademisë përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe Sekretari Shkencor. Kryetari emërohet nga Presidenti i Republikës mbi bazën e propozimit të KRASH-it. KRASH-i i propozon Presidentit të Republikës së paku dy kandidatura nga radhët e anëtarëve të rregullt të Asamblesë ekzistuese.
2. Zëvendëskryetari dhe Sekretari Shkencor i Akademisë emërohen nga Këshilli i Ministrave mbi bazën e propozimit të KRASH-it. Kandidatët duhet të jenë nga radhët e anëtarëve të rregullt të Asamblesë ekzistuese.
3. Kryesia e Përkohshme emërohet brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 12
Komisioni Përzgjedhës

1. KP-ja ngrihet me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ai përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët janë figura të vlerësuara gjerësisht, brenda dhe jashtë vendit, për kontributin e tyre akademik. 3 anëtarë dhe Kryetari i KP-së propozohen nga Kryesia e Përkohshme e Akademisë, të cilët e ruajnë anëtarësinë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 5 anëtarë të tjerë të KP-së janë personalitete shkencore të huaja, që propozohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në bazë të rekomandimit të KALSH-it.
2. Komisioni Përzgjedhës përcakton dhe i propozon KRASH-it shpërndarjen e vendeve vakante, sipas fushave të shkencës dhe kriteret, që duhet të plotësojnë kandidatët për këto vende. Ky komision përzgjedh prej tyre anëtarët e rregullt të Asamblesë së Akademisë për vendet vakante.
3. Mbledhjet e KP-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë së paku 7 anëtarë.
4. Anëtarët e rinj të Akademisë, të përzgjedhur nga KP-ja, shpallen nga Kryesia e Përkohshme e Akademisë, mbi bazën e klasifikimit të bërë nga Komisioni Përzgjedhës.

Neni 13

1. Pasi plotësohet kuorumi i nevojshëm i Asamblesë (50 për qind plus një e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Asamblesë), ajo miraton Statutin e ri të Akademisë, jo më vonë se 4 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Anëtarët e përhershëm të Akademisë zgjidhen nga anëtarët e rregullt të Asamblesë, pasi është arritur kuorumi i nevojshëm i Asamblesë.
3. Pasi plotësohet numri i anëtarëve të rregullt dhe të përhershëm të Asamblesë, përzgjidhen anëtarët e asociuar të saj.
4. Struktura dhe organizimi i Akademisë përshtaten në përputhje me këtë ligj brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi të tij.
5. Akademia e riorganizuar zhvillon zgjedhjet e organeve drejtuese brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5579, datë 17.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.9854, datë 26.12.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002
“PËR AKCIZAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çdo person, që prodhon mallra në territorin e Republikës së Shqipërisë ose importon ngarkesa tregtare mallrash, subjekt akcize, për përpunim të miratuar në një magazinë tatimore të miratuar, detyrohet të pajiset me autorizimin e organeve tatimore. Pajisja me autorizim nga organet tatimore përkatëse bëhet sipas kushteve të caktuara nga Ministri i Financave.”.

Neni 2

Në nenin 5 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çdo person i autorizuar, sipas nenit 4 të këtij ligji, nëse kërkon të prodhojë ose të mbajë mallra akcize në ndonjë truall, ndërtesë ose mjedis tjetër, nën regjimin e pezullimit tatimor, duhet të kërkojë më parë në organet tatimore, që ato t’i miratojnë atij si magazinë tatimore truallin, ndërtesën ose mjedisin tjetër që ai disponon. Miratimi i magazinës tatimore bëhet sipas kushteve të caktuara nga Ministri i Financave.”.

Neni 3

Shtojca 1, që i bashkëlidhet ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër e titull, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5580, datë 17.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

SHTOJCA 1
MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kodi NK	PËRSHKRIMI	SHKALLA TATIMORE
I	KAFE	
09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	50 lekë/kg
09 01 21 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	100 lekë/kg

09 01 22 00		
09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
21 01 11 21 01 12	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafë etj.)	250 lekë/kg
II	LËNGJE FRUTASH, UJË DHE PIJE FRESKUESE	
20 09	Lëngje frutash dhe perimesh të pafermentuara, pa shtesa alkoolike, që përmbajnë ose jo lëndë ëmbëltuese	2 lekë/litri
22 02	Ujërat minerale ose të gazuara, me ëmbëlsues ose aromatizues shtesë, pijet freskuese joalkoolike, përjashtim lëngjet e frutave	2 lekë/litri
III	BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE	
22 03	Birrë e bërë nga malto - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi ≤ 200 000 hektolitër/vit - Nga prodhues vendas e të huaj, me sasi > 200 000 hektolitër/vit	30 lekë/litri 40 lekë/litri
22 04	Verë dhe verërat e gazuara, shampanjë, musht rrushi - nga prodhues vendas e të huaj, që prodhojnë më pak se 10 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj, që prodhojnë më shumë se 10 000 hektolitër/vit	20 lekë /litri 35 lekë /litri
22 05	Vermut e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi ≤ 300 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi > 300 hektolitër/vit	20 lekë /litri 35 lekë /litri
22 06	Të tjera pije të fermentuara (p.sh. cider, cider dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të papërmendura diku tjetër	20 lekë /litri
22 07 10 00	Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 për qind ose më tepër	400 lekë/litri
22 07 20 00	Alkool etilik i denaturuar	0
22 08	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit mbi 12 për qind. - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi ≤ 20 000 hektolitër/vit. - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi > 20 000 hektolitër/vit Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit deri në 12 për qind	150 lekë /litri 200 lekë /litri 70 lekë /litri
22 08 20 29	Raki	100 lekë /litri
IV	DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ	
24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 240 lekë/kg
24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	40 lekë/paketa
24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	1 500 lekë/kg
V	NËNPRODUKTET E NAFTËS	
	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013gr/litër	37 lekë /litri

27 10 11 41 27 19 11 45 27 10 11 49	- Me më pak se 95 oktan - Me 95-98 oktan - Me 98 e më shumë oktan Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër	50 lekë /litri
27 10 11 51 27 10 11 59	- Me më pak se 98 oktan - Me 98 e më shumë oktan	
27 10 19 11 deri	Vajgurët	20 lekë/litri
27 10 19 29 27 10 19 21	Karburantet, tip vajguri	0
27 10 19 31 deri 27 10 19 49	Vajra të rënda (gazoil)	75 për qind, por jo më shumë se 37 lekë për litër dhe jo më pak se 27 lekë për litër.
27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	13 lekë /kg
27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/ kg
27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte dhe vajra të tjera	1 lek/kg
27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
27 14 90 00	- Të tjera (bitum dhe asfalt natyror; asfaltet dhe gurët asfaltikë)	5 lekë/kg
27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpininën e katranit mineral (masticet bituminoze)	5 lekë/kg
29 01 29 02	Hidrokarbure aciklike dhe ciklike përfshirë (etilen, benzen, toluol, ksilol)	5 lekë/kg
34 03 19 91 34 03 99 10	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg
VI	ARTIKUJ KOZMETIKË, PARFUMERI DHE TUALETI	
33 03 00 10	Parfume	60 për qind
33 03 00 90	Ujëra tualeti	60 për qind
33 07 20 00	Deodorante	60 për qind
VII	LLAMPA INKADESHENTE	
8539 21 92	Më tepër se 100 V	100 për qind
8539 21 98	Jo më tepër se 100 V	100 për qind
8539 22 10	Llampat reflektor	100 për qind
8539 22 90	Të tjera	100 për qind
8539 29 92	Më tepër se 100 V	100 për qind
8539 29 98	Jo më tepër se 100 V	100 për qind

LIGJ
Nr.9855, datë 26.12.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9643, DATË 20.11.2006 "PËR
PROKURIMIN PUBLIK"**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 "Përkufizime", pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me këtë përmbajtje:

"8/1. "Marrëveshja publike kuadër" është marrëveshja ndërmjet autoritetit kontraktor dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë për prokurimin e energjisë elektrike dhe të hidrokarbureve, e cila ka për qëllim të krijojë kuadrin e përgjithshëm për lidhjen e kontratave të veçanta për mallrat që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore."

Neni 2

Në nenin 7 "Përjashtimet e veçanta" bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

- a) Pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:
"dh) blerjen e energjisë elektrike të prodhuar në vend."
- b) Në paragrafin e fundit shkronja "d" zëvendësohet me shkronjën "dh".

Neni 3

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 11/1

Marrëveshja publike kuadër

1. Marrëveshja publike kuadër përcakton kushtet e përgjithshme lidhur me prokurimin e energjisë elektrike ose hidrokarbureve, periudhën e prokurimit, e cila nuk mund të tejkalojë 24 muaj, si dhe kur është e përshtatshme, kushtet që kanë lidhje me çmimin dhe sasinë e mallit që prokurohet sipas kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja publike kuadër miratohet paraprakisht nga enti rregullator i sektorit përkatës.

2. Për lidhjen e marrëveshjes publike kuadër përdoret procedura e hapur ose e kufizuar e prokurimit, sipas përcaktimeve të neneve 30 dhe 31 të këtij ligji."

Neni 4

Në nenin 13 pika 2, pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "ç/1" me këtë përmbajtje:

"ç/1) për procedurat e prokurimit për blerjen e energjisë elektrike, Agjencia e Prokurimit Publik harton dokumentet standarde të veçanta. Në hartimin e tyre APP-ja u referohet kushteve të kontratave tip që përdoren gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare të shitblerjes së energjisë elektrike, për aq sa ato nuk vijnë në kundërshtim me këtë ligj;"

Neni 5

Në nenin 33 pika 2, pas shkronjës "c" shtohen shkronjat "ç", "d" e "dh" me këtë përmbajtje:

"ç) për mallrat e kuotuarra dhe të blera në bursën e mallrave, në përputhje me rregullat e prokurimit publik;

d) për blerje, që mundësojnë prokurimin e mallrave për një kohë lëvrime shumë të shkurtër, ose për një rast veçanërisht të leverdishëm, që paraqitet në një kohë shumë të shkurtër dhe me një çmim, dukshëm, më të ulët se çmimet normale të tregut dhe në përputhje me kriteret e parashikuara në rregullat e prokurimit publik;

dh) për kontratat, që do të prokurohen në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me kusht që të plotësohen kërkesat e përcaktuara në nenet 11/1 dhe 35/1 të ligjit."

Neni 6

Pas nenit 35 shtohet neni 35/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 35/1

Procedurat e kontratave që bazohen në marrëveshjen publike kuadër

1. Kontratat, që janë bazuar mbi një marrëveshje kuadër, shpallen fituese në përputhje me procedurat e parashikuara në pikat 3 e 4 të këtij neni, ose duke përdorur procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, të përcaktuar në nenin 33 të këtij ligji. Procedurat për lidhjen e kontratave mund të zbatohen vetëm ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, pjesëtarë fillestarë (palë) të marrëveshjes kuadër.

2. Në prokurimin e kontratave, të bazuara mbi një marrëveshje publike kuadër, autoriteti kontraktor nuk mund të bëjë, në asnjë lloj rrethane, ndryshime të ndjeshme të kushteve, që janë përcaktuar në atë marrëveshje kuadër, veçanërisht në rastin që i referohet pikës 5 të këtij neni.

3. Kur një marrëveshje publike kuadër është lidhur me një operator ekonomik të vetëm, kontratat e bazuara mbi atë marrëveshje jepen brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Në lidhjen e këtyre kontratave, autoriteti kontraktor komunikon me shkrim me operatorin ekonomik të marrëveshjes publike kuadër, duke i kërkuar atij të dorëzojë ofertën e tij, në përputhje me kërkesën.

4. Kur marrëveshja publike kuadër është lidhur me disa operatorë ekonomikë, numri i tyre nuk mund të jetë më pak se tre, për sa kohë ka një numër të mjaftueshëm operatorësh ekonomikë, që përmbushin kriteret e përzgjedhjes dhe/ose të ofertuesve të pranuar, që plotësojnë këto kriteret.

Kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër, me disa operatorë ekonomikë, mund të lidhen në bazë të zbatimit të kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër, pa rihapur konkurrimin, ose kur jo të gjitha kushtet janë parashikuar në marrëveshjen kuadër, me kushte të tjera, të hartuara e të specifikuar më saktë, në zbatim të marrëveshjes kuadër, në përputhje me procedurat e mëposhtme:

a) për çdo kontratë, që do të lidhet, autoriteti kontraktor njofton me shkrim ose me çfarëdo lloj mënyre tjetër, në zbatim të nenit 24 të ligjit, operatorët ekonomikë, që përmbushin kërkesat për zbatimin e kontratës dhe që janë palë në marrëveshjen kuadër;

b) autoriteti kontraktor cakton një afat kohor të mjaftueshëm, që lejon paraqitjen e ofertave për çdo kontratë të veçantë, duke marrë parasysh faktorë të tillë, si kompleksitetin e objektit të kontratës dhe kohën që nevojitet për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave;

c) ofertat duhet të paraqiten me shkrim ose me çfarëdo lloj mënyre tjetër, në zbatim të nenit 24 të këtij ligji dhe përmbajtja duhet të mbahet e fshehtë, deri në skadimin e afatit kohor përfundimtar për përgjigje;

ç) autoriteti kontraktor shpalli fitues të kontratës operatorin, që ka paraqitur ofertën më të mirë, sipas kriterëve të përzgjedhjes, të përcaktuara në bazë të marrëveshjes kuadër."

Neni 7

Në kreun V, pas nenit 37 shtohet neni 37/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 37/1

Për qëllime optimizmi, lejohet përdorimi njëherësh, për të njëjtën periudhë kohore, i llojeve të ndryshme të procedurave të prokurimit të energjisë elektrike."

Neni 8

Në nenin 43 bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2.1. Në procedurën e hapur për prokurimin e energjisë elektrike, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, afati kohor për marrjen e ofertave është jo më pak se 20 ditë, nga data në të cilën është botuar njoftimi i prokurimit.

Në rast të dështimit të kësaj procedure prokurimi ose të mosplotësimit të sasive të energjisë elektrike të kërkuar, autoriteti kontraktor fillon një procedurë të hapur, të re dhe afati kohor për marrjen e ofertave është jo më pak se 10 ditë, nga data në të cilën është botuar njoftimi i prokurimit."

b) Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

"8. Kur njoftimet janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, afatet kohore për marrjen e ofertave, të parashikuara në pikat 2 e 5 të këtij neni, për procedura të hapura, mund të shkurtohen 7 ditë, ndërsa afatet kohore për marrjen e kërkesës për pjesëmarrje, të parashikuara në shkronjat "a" e "b" të pikës 3 dhe në shkronjat "a" e "b" të pikës 6 të këtij neni, për procedurat e kufizuara dhe me negocim, mund të shkurtohen 5 ditë."

Neni 9

Në nenin 49, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Vlera e sigurimit të ofertës, në rastet e procedurave të prokurimit për blerjen e energjisë elektrike, duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këto procedura prokurimi."

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5581, datë 17.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9856, datë 26.12.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995
"PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 24 "Organizatat jofitimprurëse", shkronjat "a", "b" dhe "c" shfuqizohen.

Neni 2

Neni 24/1 shfuqizohet.

Neni 3

Neni 25/2 "Barnat e pajisjet mjekësore" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25/2

Furnizimi i barnave dhe i ambalazheve e materialeve, që përdoren për prodhimin dhe konfeksionin e barnave, janë furnizime të përjashtuara."

Neni 4

Në nenin 26 pika 2.1. ndryshohet si më poshtë:

"2.1. Për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht llojit të saj, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së deri në 12 muaj. Sipas kësaj skeme, TVSH-ja nuk paguhet në doganë në çastin e importit.

Këshilli i Ministrave përcakton me udhëzim skemën e shtyrjes së pagesës."

Neni 5

Në nenin 26/1 shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre, në të gjitha rrethanat brenda vendit, është i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Kjo shkronjë nuk zbatohet për furnizimin në import të periodikëve, revistave, shtypshkrimeve dhe librave të çdo lloji."

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5584, datë 18.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9857, datë 26.12.2007

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.2, DATË 19.12.2007
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9645, DATË
27.11.2006 “PËR BUXHETIN E SHETIT TË VITIT 2007”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ nr.2, me fuqinë e ligjit, datë 19.12.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar”.

**Shpallur me dekretin nr.5582, datë 17.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**LIGJ
Nr.9858, datë 27.12.2007**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË USHTARAKE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ligji nr.9419, datë 20.5.2005 “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përgatisë aktet e nevojshme, sipas përcaktimeve të bëra në Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5583, datë 17.1.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

STRATEGJIA USHTARAKE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

I. HYRJE

1. Qëllimi i Strategjisë Ushtarake

1.1. Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë është një dokument i rëndësishëm që përmban parimet dhe konceptet bazë për zhvillimin dhe përdorimin e Forcave të Armatosura për arritjen e objektivave të politikës së mbrojtjes. Ajo rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe përcakton synimet, objektivat, kapacitetet e kërkuara dhe burimet për krijimin e një force të aftë për realizimin e misionit të saj kushtetues.

1.2. Strategjia Ushtarake hedh bazat konceptore të përgatitjes së Forcave të Armatosura për realizimin e kalimit nga konceptet tradicionale të mbrojtjes së mëvetësishme të vendit në ato të mbrojtjes kolektive, duke e vënë theksin kryesisht në përmbushjen e angazhimeve dhe në zhvillimin e menaxhimit efektiv të kapaciteteve të nevojshme për anëtarësim në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Duke dhënë konceptet bazë në nivelin strategjik, ajo i hap rrugë zhvillimit të koncepteve, krijimit të kapaciteteve dhe përdorimit të tyre në nivelin operacional.

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë vlerëson zhvillimet e mjedisit të sigurisë me ndikim në sigurinë kombëtare, të cilat mbartin implikime ushtarake dhe kërkojnë angazhimin e Forcave të Armatosura.

1.3. Strategjia Ushtarake mbështetet në analizat e kryera nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare mbi format, forcat, burimet, mjetet e nevojshme për garantimin e sigurisë së vendit, si dhe në përvojën kombëtare dhe atë të vendeve të tjera në zhvillimin e dokumenteve të tilla.

2. Parimet bazë të Strategjisë Ushtarake:

- Mbështetja e mbrojtjes në mundësitë dhe potencialet reale të vendit (njerëzore, ekonomike, teknologjike dhe mjedisore). Në përputhje me analizën e mjedisit të sigurisë dhe duke vlerësuar rreziqet e kërcënimit aktuale e të pritshme, Strategjia Ushtarake përcakton si parim të rëndësishëm shfrytëzimin e të gjitha mundësive reale e të burimeve të vendit për mbrojtje.

- Mbështetja e mbrojtjes së interesave kombëtare në një kontekst më të gjerë të mbrojtjes kolektive. Duke aspiruar për t'u integruar në NATO, Shqipëria përgatitet për të kontribuar në mbrojtjen kolektive të Aleancës dhe për të përfutur prej saj.

- Zhvillimi dhe përdorimi i Forcave të Armatosura si një instrument i rëndësishëm për realizimin e objektivave të sigurisë së vendit dhe për të kontribuar për sigurinë në kuadër rajonal e ndërkombëtar. Duke i konsideruar Forcat e Armatosura si një element të rëndësishëm për mbrojtjen e vendit, Strategjia Ushtarake përcakton gjithashtu objektivat dhe misionin e tyre për të kontribuar në sigurinë rajonale e më gjerë.

- Ruajtja e një baraspeshe të sigurt ndërmjet burimeve që kërkohet të vihen në dispozicion të mbrojtjes dhe mundësive reale të vendit. Burimet e pamjaftueshme materiale dhe financiare kërkojnë rritjen e efikasitetit të shfrytëzimit të tyre me qëllim që me burimet e disponueshme të sigurohet arritja e objektivave që përcakton kjo strategji për mbrojtjen e vendit dhe për kontributin në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

- Përpunimi i një vizioni strategjik koherent për të sotmen dhe për të ardhmen, duke identifikuar sfidat aktuale e ato të pritshme dhe rrugët për përballimin e tyre. Objektivat, konceptet dhe përparësitë e përcaktuara në këtë strategji synojnë jo vetëm zhvillimin afatshkurtër e afatmesëm të Forcave të Armatosura dhe të të gjithë sistemit të mbrojtjes së vendit, por edhe hedhjen e bazave të sigurta për arritjen e objektivave themelore afatgjatë.

- Rritja e kontrollit civil demokratik mbi Forcat e Armatosura. Ky kontroll konsiderohet si një ndër parimet bazë për garantimin e zhvillimit të një force dhe sistemi mbrojtjeje në përputhje me parimet demokratike perëndimore, të cilat janë vlera të patjetërsueshme të të gjitha ushtrive të vendeve të NATO-s, ku aspirojmë të integrohemi.

II. MJEDISI I SIGURISË

2.1. Situata gjeostrategjike në rajon

Zhvillimet botërore dhe rajonale në fillim të mijëvjeçarit të ri kanë sjellë ndryshime të thella të mjedisit gjeostrategjik, duke përmirësuar ndjeshëm klimën e përgjithshme të marrëdhënieve ndërshtetërore, por, në të njëjtën kohë, duke nxjerrë në pah sfida e kërcënime të reja.

Shqipëria është pjesë e një mjedisi gjeostrategjik që konsiderohet, nga njëra anë, si një mjedis ballkanik me të gjitha problemet historike të trashëguara të këtij rajoni dhe, nga ana tjetër, si një mjedis evropian mbi të cilin vendet demokratike perëndimore ushtrojnë një ndikim pozitiv për stabilitetin, demokratizimin dhe integrimin e tij.

Nga vendet e rajonit është kuptuar se, për të arritur progres në drejtim të stabilitetit rajonal, është e domosdoshme të hiqet dorë nga nacionalizmi dhe përpjekjet për zbatimin e programeve nacionaliste të gjeopolitikës së vjetër dhe të përqafohet koncepti i integritetit që po i jep formë Evropës së shekullit të njëzetënjtë.

Prania e NATO-s, BE-së, OSBE-së, OKB-së dhe e organizmave të tjerë ndërkombëtarë në rajon për konsolidimin e stabilitetit dhe nxitjen e bashkëpunimit e të mirëkuptimit midis vendeve të tij. Bashkëpunimi rajonal në kuadër të programeve të këtyre organizmave, luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e besimit dhe të politikës së hapur në rajon. Pjesëmarrja e vendeve të rajonit në programin e Partneritetit për Paqe (PfP), si dhe aspirata e tyre për anëtarësim në Aleancë, ka ndikuar pozitivisht në situatën e sigurisë. Situata e stabilitetit, e sigurisë dhe e bashkëpunimit, që karakterizon vendet e Aleancës, gradualisht po eksportohet në vendet e Ballkanit, duke krijuar kushte të favorshme për një rajon të sigurt dhe me premisa zhvillimi në të gjitha fushat.

Pavarësisht nga përparimet e bëra këto vitet e fundit, rajoni vazhdon të përballlet me sfidat që rrjedhin nga faktorët historikë.

2.2. Kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë së Shqipërisë

Identifikimi i rreziqeve dhe i kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë së vendit është një nga parakushtet për parashikimin e tyre dhe për përcaktimin e kërkesave e të nevojave për përgatitjen e kapaciteteve të FA për t'i përballuar ato.

Aktualisht mundësia e një agresioni ushtarak ndaj Republikës së Shqipërisë është minimizuar shumë dhe nuk parashikohet për një periudhë afatmesme. Në këto kushte, kur Shqipëria nuk pritet të përballlet me kërcënime simetrike, theksi vihet në identifikimin e rreziqeve dhe të kërcënimeve asimetrike, dhe në përgatitjen për përballimin e tyre.

2.2.1. Kërcënime dhe rreziqe të brendshme asimetrike

Përparimet e dukshme në forcimin e institucioneve të shtetit ligjor, ekzistenca e një konsensusi të gjerë politik për çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit, konsolidimi i kontrollit demokratik mbi Forcat e Armatosura, si dhe treguesit e rritjes së ekonomisë, ndikojnë pozitivisht në krijimin e një mjedisi të brendshëm të sigurt.

Sidoqoftë vazhdojnë të ekzistojnë dhe të ushtrojnë ndikimin e tyre negativ mbi sigurinë e vendit dukuri të tilla si:

Krimi i organizuar përbën një faktor me ndikim në mjedisin e sotëm të sigurisë së vendit. Bashkëpunimi i organizatave kriminale brenda e jashtë vendit dhe lidhjet e mundshme midis krimit të organizuar dhe organizatave terroriste të huaja përbëjnë një rrezik të madh potencial ndaj sigurisë së vendit.

Zhvillimi ekonomik dhe niveli i papunësisë në moshën aktive për punë (20-40 vjeç) favorizojnë rekrutimin e kësaj kategorie nga organizatat kriminale, duke krijuar një premisë për rritjen e faktorëve negativë që ndikojnë në sigurinë e vendit. Ekzistenca e korrupsionit, evazoni fiskal, ekzistenca e ekonomisë informale vështirësojnë mundësinë e rritjes së burimeve materiale e financiare të domosdoshme për zhvillimin e institucioneve të sigurisë.

Fatkeqësitë natyrore, aksidentet industriale e mjedisore dhe përhapja e epidemive, megjithëse janë të natyrës joushtarake, paraqesin rreziqe permanente, që mund të shndërrohen me shpejtësi në kërcënime potenciale me pasoja të paparashikueshme. FA ndihmojnë në eliminimin e pasojave që rrjedhin nga rreziqe të tilla dhe ndihmesa e tyre është e karakterit joushtarak.

Probleme të tjera që ndikojnë në sigurinë e vendit janë edhe korrupsioni, trafiqet ilegale, emigracioni klandestin etj.

2.2.2. Kërcënime dhe rrezeqe të jashtme simetrike dhe asimetrike

Gjendja aktuale e sigurisë në rajon dhe më gjerë, me probleme dhe zgjidhje ende të papërcaktuara, që burojnë më së shumti nga historia e tij komplekse, me institucione demokratike të brishta dhe zhvillim ekonomik të pamjaftueshëm, vazhdon të përmbajë kërcënime dhe rrezeqe simetrike dhe asimetrike.

Destabiliteti rajonal është një rrezik potencial, i cili do të vazhdojë të ekzistojë për sa kohë të ekzistojnë ndjenjat radikale etnike e fetare dhe prirjet për përdorimin e forcës ushtarake për realizimin e tyre. Një rikthim i dhunës a destabilitetit në rajon do të ndikonte edhe në sigurinë e Shqipërisë.

Terrorizmi, si një dukuri globale, mund të përbëjë një rrezik real për sigurinë e Shqipërisë. Nuk përjashtohet mundësia që Shqipëria, si një vend aspirant për anëtarësim në NATO, të bëhet objekt i sulmeve të drejtuara ndaj aleancës ose ndaj vendeve anëtare të saj.

Trafiqet e paligjshme po shndërrohen në një dukuri që nuk njeh kufij. Pozita gjeografike, kushtet ekonomike e sociale janë parakushte që vende të rajonit të kthehen në burim dhe bazë e favorshme logjistike, vepruese e ndërlydhe për trafikantët, duke vënë në rrezik ambientin e sigurisë rajonale.

Përhapja e ADM përbën një shqetësim në rritje për sigurinë në tërësi. Në tregun ilegal global ekziston tendenca e trafikimit të armëve të dëmtimit në masë dhe të lëndëve që shërbejnë për prodhimin e tyre. Gjasa e pranisë së këtyre materialeve në rajonin tonë, në duart e organizatave kriminale e terroriste, do të ishte e rrezikshme dhe me pasoja negative për sigurinë.

2.2.3. Mjedisi i sotëm i sigurisë, i brendshëm dhe i jashtëm, me zhvillimet e tij pozitive, krijon mundësi të mira për transformimin e FA dhe përgatitjen e tyre për t'u integruar në strukturat ushtarake të NATO-s. Këto mundësi shtohen edhe më shumë nga zhvillimet mjaft pozitive në mjedisin ushtarak të sigurisë, siç janë: rritja e buxhetit të mbrojtjes, mbështetja politike e gjithanshme për Forcat e Armatosura, mbështetja publike dhe rritja e besimit të partnerëve tanë. Gjithsesi, rreziqet e kërcënimit e reja që karakterizojnë këtë mjedis, rritin dukshëm domosdoshmërinë e përpunimit të koncepteve e të strukturave të reja të FA për përballimin e situatave që mund të vënë në rrezik interesat e Republikës së Shqipërisë.

2.3. Sistemi i mbrojtjes i RSH në kontekstin e ri të sigurisë

Në rrethanat e sotme dhe në të ardhmen e pritshme, asnjë shtet nuk mund të sigurojë paqe, siguri dhe prosperitet të qëndrueshëm duke vepruar më vete. Në këto kushte, Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë mbështetet **në konceptin e integritetit të shpejtë të vendit tonë në strukturat kolektive** të sigurisë evropiane e euroatlantike, me theks të veçantë në ato të NATO-s dhe të BE-së.

2.3.1. Forcat e Armatosura janë një nga elementët më të rëndësishëm të sistemit të sigurisë së vendit. Ato e bazojnë përmbushjen e misionit të vet kushtetues në një kuadër ligjor të standardeve demokratike të zhvilluar më tej në Strategjinë Ushtarake dhe në një paketë doktrinale bashkëkohore. Reforma e mbrojtjes synon veçanërisht rishikimin periodik të zhvillimit e të pozicionimit të Forcave të Armatosura në përshtatje me situatat e reja të mjedisit të sigurisë, duke pasqyruar ndryshime organizative, misione dhe detyra të reja në përputhje me nevojat aktuale të vendit dhe me kërkesat që rrjedhin nga integrimi në strukturat euroatlantike. Këto ndryshime synojnë largimin nga koncepti tradicional i mbrojtjes territoriale dhe përqendrimin të krijimit i kapaciteteve të përshtatshme, të afta për të përmbushur detyrimet në kuadër të mbrojtjes kolektive.

2.3.2. Shqipëria është një vend partner dhe aspirant për anëtarësim në NATO, e përfshirë në negociatat e marrëveshjes së stabilizim-asocimit me BE, si dhe në një numër të konsiderueshëm nismash rajonale. Një nga qasjet e rëndësishme për rritjen e nivelit të sigurisë së vendit përqendrohet në respektimin, pjesëmarrjen aktive dhe kontributin në nismat **për rritjen e mirëbesimit politiko-ushtarak** në rajon, si dhe në zbatimin me sukses të programeve e standardeve të Partneritetit për Paqe (PfP) dhe të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit për integrim të merituar në strukturat euroatlantike dhe në ato të Bashkimit Evropian.

Strategjia Ushtarake mbështetet në Konceptin Strategjik të Aleancës dhe zhvillohet në përputhje me të. Shqipëria, si vend aspirant për t'u anëtarësuar në NATO, përgatitet të respektojë dhe t'i përmbahet nenit 5 të Aleancës, duke e konsideruar çdo sulm ndaj një vendi të NATO-s si sulm ndaj

Shqipërisë. Nisur nga ky angazhim, vëmendje e veçantë i kushtohet krijimit të kapaciteteve përkatëse që do t'i shërbejnë jo vetëm mbrojtjes së vendit, por edhe pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s në kuadër të mbrojtjes kolektive, si dhe në operacionet e drejtuara prej saj për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë edhe jashtë zonës së saj të përgjegjësisë.

2.3.3. Zbatimi i programeve të bashkëpunimit dy e shumëpalësh dhe i standardeve të integritetit lidhet ngushtë edhe me vazhdimin e kontributit konkret të Shqipërisë me forca dhe mbështetje të tjera kombëtare në misionet e përbashkëta në interes të paqes e sigurisë rajonale e globale, të kryera me mandatin e organizmave ndërkombëtare ku vendi ynë është anëtar.

2.3.4. Mekanizmat paqësorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që përfshijnë respektimin dhe zbatimin e traktateve e ligjeve ndërkombëtare, **pjesëmarrjen aktive në organizatat e sigurisë rajonale e globale**, si dhe në proceset e negociatave dypalëshe e shumëpalëshe, shprehen në mënyrë të qartë në politikën e jashtme dhe nismat e Shqipërisë në interes të sigurisë.

2.3.5. Thelbin e reformës në fushën e sigurisë, si një proces gjithëpërfshirës e ciklik, e përbën **konsolidimi i mëtejshëm i të gjitha institucioneve të sigurisë**. Sfidat e reja kërkojnë zhvillimin e strategjive të reja sektoriale në diplomaci, ekonomi, mbrojtje, rend, drejtësi, shërbimet informative etj., duke i reformuar institucionet përkatëse me synimin për t'i përballuar këto rrezeqe.

2.3.6. Për rritjen e sigurisë kombëtare sot rol të rëndësishëm luan shfrytëzimi me efikasitet i fuqisë së informacionit. Sigurimi i informacionit të shpejtë dhe të saktë lidhet pazgjidhshmërisht me vendimmarrjen e shpejtë dhe të saktë dhe me veprimet në kohën e duhur për të shmangur pasoja të caktuara në dëm të sigurisë kombëtare. Informacioni vlerësohet si faktor gjithnjë e më i rëndësishëm për forcimin e sigurisë kombëtare, duke mbajtur parasysh synimin themelor të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive kushtetuese të qytetarëve në fushën e ruajtjes dhe të shkëmbimit të informacionit të besueshëm, nëpërmjet zhvillimit të komunikimit dhe mediave të lira të vendit. Ruajtja e sigurisë kombëtare kërkon gjithashtu ndalimin e përdorimit të informacionit për qëllime të manipulimit të ndërgjegjes së publikut. Po ashtu, kërkohet mbrojtja me ligje të veçanta e informacionit të klasifikuar shtetëror në fusha të caktuara, si dhe të atij ndërshtetëror ose me organizma ndërkombëtarë, sipas marrëveshjeve ndërmjet palëve.

2.3.7. Strategjia Ushtarake mban parasysh e vlerëson edhe ndikimin e **faktorit mjedisor** në sigurinë e vendit. Mbrojtja, restaurimi dhe riprodhimi i natyrës shqiptare siguron një mjedis ekologjik e kushte të favorshme për jetesë për qytetarët dhe shoqërinë shqiptare. Interesat kombëtare kërkojnë shfrytëzimin racional të burimeve të natyrës nëpërmjet zhvillimit të një strategjie të baraspeshuar sektoriale, nga njëra anë, për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe, nga ana tjetër, për shfrytëzimin e burimeve të shumëllojshme natyrore në interes të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë.

III. OBJEKTIVAT E STRATEGJISË USHTARAKE

3.1. Përgatitja e instrumentit ushtarak për përballimin e kërcënimeve dhe të rrezeqeve

Objektiv parësor i Strategjisë Ushtarake është përcaktimi i koncepteve themelore për përgatitjen e Forcave të Armatosura si instrumenti ushtarak për përballimin e kërcënimeve dhe të rrezeqeve.

Forcat e Armatosura janë një element i rëndësishëm i sistemit të mbrojtjes së vendit dhe përbëjnë instrumentin ushtarak të sigurisë së tij. Përgatitja dhe aftësimi i këtij instrumenti për të qenë në gjendje të përballojë kërcënimet dhe rreziqet që i kanosen ose mund t'i kanosen vendit në të ardhmen është një nga synimet më të rëndësishme të Strategjisë Ushtarake. Në mbështetje të këtij synimi, Strategjia Ushtarake shtron para Forcave të Armatosura tre objektiva të rëndësishëm:

- mbrojtjen e vendit nga kërcënimet dhe rreziqet e mundshme;
- përgatitjen për pjesëmarrje në operacionet e mbrojtjes kolektive të NATO-s, si dhe në kuadrin e Politikës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes të Bashkimit Europian, dhe organizmave të tjerë të sigurisë ku vendi ynë është anëtar;
- sigurimin e kapaciteteve të afta për të kontribuar në operacione joluftarake brenda dhe jashtë vendit.

Realizimi i këtyre objektivave bëhet krahas me përgatiten e FA për integrim në strukturat ushtarake të NATO-s, si dhe me zhvillimin e tyre për arritjen e standardeve të një force të së ardhmes. Në përcaktimin e objektivëve të saj, Strategjia Ushtarake merr parasysh realizimin e aspiratës së integritetit në NATO, duke llogaritur edhe përfitimet e detyrimet e pjesëmarrjes në mbrojtjen kolektive.

3.1.1. Karakteristikat dhe tiparet e Forcave të Armatosura të RSH

Forcat e Armatosura të RSH, për të përmbushur misionin e tyre kushtetues, kërkohet të jenë:

- të bashkuara, të zhdërvjellëta dhe të shpejta në konfigurim;
- të afta për të vepruar në misione të shumëllojshme, të dislokueshme në një kohë të shkurtër dhe me mëvetësi të lartë veprimi për një kohë të gjatë;
- të pajisura me teknologji bashkëkohore komandimi e kontrolli dhe të mbështetura nga një logjistikë e integruar, e aftë për të vepruar në mjedise komplekse;
- tërësisht të ndërveprueshme dhe të afta për të kryer operacione në përbërje të forcave shumëkombëshe;
- të përgatitura për të bashkëpunuar me autoritetet civile, organizatat joqeveritare dhe me agjenci të tjera në një mjedis operacioni të përbashkët;
- të përgatitura për një spektër të gjerë misionesh;
- të pajisura me kapacitete të veçanta për operacione speciale.

Krijimi i një force ushtarake **të bashkuar** mundëson shfrytëzimin me efektshmëri të plotë të kapaciteteve operacionale të të gjitha llojeve të forcave (shërbimeve) pjesëmarrëse në një mision, duke shumëfishuar mundësitë e arritjes së suksesit në operacione. Koncepti i forcës së bashkuar gjen zbatim si në organizimin strukturor, përgatitjen dhe stërvitjen e Forcave të Armatosura, ashtu edhe në kryerjen e operacioneve për përmbushjen e misionit të tyre kushtetues. Koncepti i forcës së bashkuar dhe i operacioneve të përbashkëta mundëson përmbushjen e objektivave të strategjisë ushtarake. Suksesi në realizimin e këtyre objektivave kërkon veprime të integruara, bashkëpunim të ngushtë dhe rritje të besimit ndërmjet shërbimeve.

Zhvillimi i FA synon gjithashtu krijimin e një force ushtarake të zhdërvjellët dhe të përshtatshme, në përputhje me shumëllojshmërinë e misioneve. Kjo zhdërvjelltësi nënkupton aftësinë për të organizuar e manovruar grupime forcash ose reparte të përforcuara, që ndërthuren në funksion të situatës së ndryshuar me synim plotësimin e misionit.

Përpjekje kërkohen sidomos për zhvillimin e forcave të dislokueshme, të transportueshme, të lehta dhe të afta për përmbushjen e qëllimit parësor të mbrojtjes. Këto forca duhet të karakterizohen nga efektshmëria e lartë luftarake, përdorimi i tyre në një spektër të gjerë misionesh, si dhe aftësia për t'u inkuadruar në përmbushjen e detyrave të forcave të NATO-s. Ato duhet të jenë shumë të manovrueshme, me lëvizshmëri të lartë, me aftësi mbështetëse, me mëvetësi veprimi për një kohë të gjatë dhe me nivelin e kërkuar të gatishmërisë luftarake.

Zhvillimi i një Force të Armatosur të pajisur me sisteme të teknikës dhe të armatimit bashkëkohor, si dhe mbështetja e saj në të gjitha llojet e misioneve në mjedis kombëtar e ndërkombëtar nga një **logjistikë e integruar**, e aftë për të vepruar në mjedise komplekse, është objektiv i rëndësishëm i Strategjisë Ushtarake. Logjistika përshtat kapacitetet e saj me synimet dhe objektivat e përcaktuara në Strategjinë Ushtarake, nëpërmjet vendosjes së përparësive të nevojshme për të siguruar një mbështetje të mjaftueshme, dinamike dhe në kohën e duhur për FA. Kjo mbështetje sigurohet jo vetëm nga “forca fizike” e strukturës logjistike ushtarake, por edhe nga mjedisi civil në hapësirën operacionale. Përshtatja e sistemit logjistik me strukturën e re të forcës, si dhe modernizimi i tij sigurojnë mbështetjen e nevojshme materiale për arritjen e objektivave ushtarakë strategjikë.

Strategjia Ushtarake mbështetet në konceptet e krijimit të kapaciteteve operacionale, të cilat i bëjnë Forcat e Armatosura jo vetëm të gatshme për realizimin e misionit të tyre, por edhe të afta për të **ndërvepruar** me forcat e vendeve të Aleancës Euroatlantike.

FA përgatiten për të hyrë me shpejtësi dhe efektshmëri në skenarët kompleksë, me praninë e shumë faktorëve, organizatave dhe realiteteve civile e ushtarake të ndryshme e shumëkombëshe. Mbrojtja e interesave të vendit kërkon gjithashtu integrimin e kapaciteteve ushtarake me ato të organizatave të tjera qeveritare dhe joqeveritare për menaxhimin e pasojave të një situate që rrezikon këto interesa. Integrimi fokusohet në sinkronizimin e operacioneve ushtarake si me përpjekjet e tjera brenda vendit ashtu edhe me ato të partnerëve jashtë vendit.

Strategjia Ushtarake kërkon që Forcat e Armatosura të jenë të përgatitura (të kompletuara, stërvitura, pajisura e mbështetura) **për një spektër të gjerë misionesh**. Për përmbushjen e këtij spektri misionesh, Forcat e Armatosura e përshkallëzojnë nivelin e gatishmërisë në mënyrë të përshtatshme duke siguruar përgjigje të shpejtë dhe efikase ndaj situatave konkrete të mjedisit të sigurisë.

Kjo gatishmëri arrihet nëpërmjet organizimit, planëzimit dhe stërvitjes në përgjigje të kërkesave të misionit. Angazhimi dhe stërvitja e FA gjatë kohës së paqes me forca ushtarake të vendeve të tjera është me rëndësi të madhe për sigurimin e aftësive operacionale për një përgjigje të

shpejtë.

Forcat e Armatosura synojnë të kenë në përbërje të tyre **formacione të pajisura dhe të stërvitura posaçërisht për detyra speciale**. Ato zhvillojnë kapacitete të veçanta, me struktura të vogla, të specializuara për shkatërrimin e lëndëve plasëse dhe të municioneve të paplasura, për mbrojtjen e popullsisë nga ADM, për hidrografinë, gjeografinë ushtarake, shërbimin meteorologjik të FA, për luftën kundër terrorizmit, për ngritjen, mbrojtjen e zhvillimin e institucioneve të shërbimeve publike, etj., të cilat mund të vihen në dispozicion të operacioneve shumëkombëshe, por mund të shërbejnë edhe në interes të ekonomisë së vendit e të institucioneve të tjera të shtetit.

3.2. Përcaktimi, planifikimi dhe përgatitja për të marrë nën mbrojtje atë pjesë të infrastrukturës kombëtare që vlerësohet me rëndësi vendimtare për funksionimin e jetës së vendit.

Strategjia Ushtarake, duke vlerësuar ekonominë e vendit si një nga elementët më të rëndësishëm të fuqisë kombëtare, shtron si objektiv të rëndësishëm para Forcave të Armatosura përgatitjen për mbështetur mbrojtjen e asaj pjese të infrastrukturës kombëtare që ka rëndësi vendimtare për funksionimin e jetës së vendit. Ky objektiv shtron para strukturave drejtuese të FA detyrën e bashkëpunimit të ngushtë me pushtetin qendror e vendor për përcaktimin e asaj pjese të infrastrukturës që do të merret nën mbrojtje, si dhe planifikimin e masave për të siguruar që jeta e vendit të funksionojë normalisht dhe popullsia civile të mbrohet.

3.3. Ndërtimi dhe përshtatja e infrastrukturës së vendit (rrugë, porte, aeroporte etj.) me vlerë të dyfishtë (civile e ushtarake)

Krahas zhvillimit të infrastrukturës së domosdoshme për të mbështetur strukturën dhe misionet e Forcave të Armatosura gjatë kohës së paqes, një objektiv i rëndësishëm i Strategjisë Ushtarake është edhe planifikimi i ndërtimit e përshtatjes së infrastrukturës së vendit me vlerë të dyfishtë, civile dhe ushtarake. Kjo nënkupton përfshirjen e strukturave civile shtetërore në vlerësimin e nevojave të mbrojtjes dhe sigurimin e infrastrukturës së domosdoshme për këtë qëllim. Planifikimi dhe zhvillimi i infrastrukturës kombëtare duhet të mbajë parasysh përdorimin e saj nga Forcat e Armatosura në situata të ndryshme të përmbushjes së misionit të tyre, si dhe realizimin e detyrimeve të vendit pritës në mbështetje të operacioneve të Aleancës. Qysh në kohë paqeje Këshilli i Ministrave miraton Planin Kombëtar të Infrastrukturës me vlerë të dyfishtë, civile dhe ushtarake.

3.4. Vendosja e bazave konceptore dhe e një horizonti strategjik për:

3.4.1. Modernizimin e FA

Forcat e Armatosura synojnë arritjen e niveleve cilësore nëpërmjet shndërrimit të tyre në një force profesioniste, të mirëstërvitur, të pajisur me sisteme të teknikës dhe të armatimit bashkëkohor, me mjete moderne e të ndërveprueshme, dhe të aftë për të realizuar operacione të një spektri të gjerë. Këtij qëllimi do t'i shërbejë procesi i modernizimit të FA. Ky proces rrok një spektër të plotë, pa u kufizuar vetëm te sistemet e pajisjet, por duke përfshirë doktrinën, organizimin, programet e stërvitjes, udhëheqjen dhe infrastrukturën. Modernizimi i FA do të fokusohet në disa fusha të rëndësishme, si:

- sistemi i komandimit e kontrollit;
- sistemi i informacionit, duke përfshirë sistemet e vëzhgimit të hapësirës detare e ajrore, si dhe sigurimin e sistemeve e pajisjeve të tjera të zbulimit;
- sistemet e pajisjet për mbrojtjen e trupës;
- sistemet e pajisjet për vetëmbështetjen e trupës;
- mjetet e pajisjet që sigurojnë manovrën dhe transportin e trupave;
- armatimi; dhe
- arsimimi e stërvitja.

Procesi i modernizimit të FA mbështet objektivat dhe përparësitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të ristrukturimit dhe të zhvillimit të tyre, duke synuar arritjen e kapaciteteve operacionale të kërkuara.

3.4.2. Një forcë të dislokueshme

Ndërtimi dhe zhvillimi i një force të dislokueshme do t'i shërbejë jo vetëm realizimit të misionit kushtetues të mbrojtjes së vendit, por edhe përmbushjes së kriterëve të kërkuara nga NATO për të pasur të gatshme për pjesëmarrje të menjëhershme në operacionet e Aleancës të 8 për qind të komponentit tokësor, si dhe organizimin strukturor, përgatitjen dhe pajisjen për dislokim të 40 për qind të këtij komponenti.

3.4.3. Një forcë të ndërveprueshme

Ndërveprueshmëria është detyrë dhe cilësi themelore e FA. Ajo do të sigurohet si brenda Forcës së Bashkuar ashtu edhe në operacionet shumëkombëshe të drejtuara nga NATO. Kjo nënkupton organizimin dhe stërvitjen e FA në përputhje me doktrinën dhe standardet e NATO-s, pjesëmarrjen në stërvitjet dy e shumëpalëshe, gjithnjë sipas konceptit të zhvillimit të aftësive operacionale. Fokusimi në kërkesën për krijimin dhe mbajtjen e kapaciteteve integruese dhe ndërvepruese bën të mundur realizimin me sukses të misionit të FA si në mjedisin kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në mënyrë të veçantë, pjesëmarrja në operacionet e mbështetjes së paqes është faktor i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve operacionale dhe të ndërveprueshmërisë.

3.4.4. Një forcë të aftë për t'u përshtatur, shumërolëshe, nëpërmjet ndërthurjes më optimale të llojeve të trupave

Vendosja e bazave konceptore për përgatitjen e një FA të gatshme për të vepruar me kapacitetet e duhura në kohën dhe vendin e duhur, është një objektiv i rëndësishëm i Strategjisë Ushtarake. Krijimi i strukturave të tilla, që të jenë në gjendje të përshtaten në një kohë të shkurtër në varësi të misionit për të cilin thirren, si dhe përgatitja e çdo komponenti të FA për të vepruar në operacione të përbashkëta, kërkon një fokusim në konceptet e forcave shumërolëshe e të afta për t'u përshtatur, si dhe një ndërthurje sa më optimale të trupave të luftimit, të mbështetjes së luftimit dhe të mbështetjes logjistike.

IV. ROLI, MISIONI, STRUKTURAT DHE DETYRAT E FA

4.1. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë ndërtuar, përgatiten e funksionojnë sipas parimeve themelore të ndërtimit e të funksionimit të organizmave ushtarakë në shoqëritë demokratike. Ato mbështeten në një kuadër të plotë ligjor. Në marrëdhëniet e tyre me shoqërinë, ato i nënshtrohen kontrollit civil demokratik dhe angazhohen për kryerjen e misionit kushtetues: **ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, mbrojtjen dhe mbështetjen e popullit në kohë paqeje, krize e lufte, si dhe dhënien e kontributit për paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë.**

- Forcat e Armatosura përbëhen nga Forca Tokësore, Forca Ajrore e Forca Detare.
- Forcat e Armatosura integrohen në tre komanda kryesore: Komanda e Forcës së Bashkuar (KFB), Komanda e Mbështetjes (KM) dhe Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes (KDS).
- Struktura e FA është në proces transformimi në përputhje me kërkesat dhe standardet e Aleancës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Shtabi i Përgjithshëm është struktura më e lartë ushtarake në nivel strategjik e FA.

4.1.1. FA në kohë paqeje kanë për detyrë:

- Të organizohen, të stërviten dhe të pajisen për të siguruar aftësitë dhe gatishmërinë e nevojshme për realizimin e misionit të ngarkuar.
- Të monitorojnë dhe të vëzhgojnë, me kapacitetet e veta dhe në bashkëpunim me NATO-n e partnerët, hapësirën tokësore, ajrore e detare, për paralajmërimin në kohë të kërcënimeve e rreziqeve dhe marrjen e masave për përballimin e tyre.
- Të përgatiten dhe të sigurojnë mbështetjen e nevojshme të autoriteteve vendore dhe të popullsisë për përballimin e emergjencave civile të shkaktuara nga katastrofat natyrore ose nga dora e njeriut, siç përcaktohet me ligj.
- Të përgatiten dhe të kontribuojnë në Operacione në Mbështetje të Paqes të drejtuara nga NATO, BE, OKB ose si pjesë e koalicioneve të ndryshme.
- Të arrijnë ndërveprueshmërinë dhe kapacitetet e nevojshme për t'u bërë pjesë e strukturave kolektive të sigurisë euroatlantike.
- Të përgatiten dhe të sigurojnë mbështetjen e nevojshme të strukturave të tjera për luftën kundër terrorizmit.
- Të planifikojnë masa për parandalimin e dëmtimit të mjedisit dhe ta menaxhojnë e të mbrojnë atë gjatë veprimtarive ushtarake, si dhe të veprojnë për eliminimin e dëmtimeve në mjedis të shkaktuara nga faktorë të tjerë.
- Të bashkëpunojnë me strukturat e sigurisë publike për t'i mbështetur ato sipas kërkesës dhe kur lejohet me ligj.

4.1.2. FA në kohë krize kanë për detyrë:

- Të sigurojnë mbrojtjen e vendit dhe të popullsisë në rast kërcënimesh, incidentesh, fatkeqësish a katastrofash natyrore.
- Të bashkëpunojnë dhe të mbështetin strukturat e sigurisë publike për ruajtjen e rendit

kushtetues (marrja nën ruajtje e objekteve të rëndësishme të veçantë).

- Të bashkëpunojnë me strukturat e tjera brenda dhe jashtë vendit për të parandaluar trafiket e paligjshme të çdo lloji dhe për të luftuar terrorizmin.

4.1.3. FA në kohe lufte kanë për detyrë:

- Të mbrojnë tërësinë territoriale të vendit.
- Të mbrojnë popullsinë e Republikës së Shqipërisë.
- Të bashkërendojnë dhe të sigurojnë inkuadrimin i masave tona mbrojtëse me ato të vendeve partnere në kuadrin e një mbrojtjeje kolektive (rajonale).

4.2. Shtabi i Përgjithshëm, si struktura ushtarake më e lartë në Forcat e Armatosura, është ndërtuar si shtab i bashkuar strategjik dhe funksionon sipas standardeve të NATO-s. Misioni i tij është: **planifikimi, zhvillimi e drejtimi i një force luftarake të bashkuar, me komponentin tokësor, detar e ajror, të aftë për të plotësuar misionin e vet kushtetues.**

4.3. Komanda e Forcës së Bashkuar përbëhet nga: Komanda e Shtabit, Forca Tokësore (Brigada e Reagimit të Shpejtë, Regjimenti Komando dhe Brigada e Mbështetjes Rajonale), Forca Detare (Brigada Detare), Forca Ajrore (Brigada Ajrore), si dhe Batalioni Logjistik e Batalioni i Komunikimit. Ajo fokusohet kryesisht në organizimin e kryerjen e operacioneve, si dhe në stërvitjen kolektive të strukturave për kryerjen e misionit.

Misioni i KFB është: Planifikimi, drejtimi dhe kryerja e operacioneve luftarake në interes të ruajtjes së pavarësisë së vendit, mbrojtjes së tërësisë territoriale dhe rendit kushtetues, pjesëmarrja në operacione jo-luftarake në raste fatkeqësish brenda RSH, në misione jashtë vendit, si dhe përgatitja për të marrë pjesë në operacione në kuadër të mbrojtjes kolektive të Aleancës Euroatlantike.

Për realizimin e misionit të saj, detyrat kryesore të Komandës së Forcës së Bashkuar janë:

- Stërvitja e trupave, sigurimi i kapaciteteve dhe i gatishmërisë së nevojshme për realizimin e misionit të ngarkuar.

- Monitorimi dhe vëzhgimi, me kapacitetet e veta dhe në bashkëpunim me NATO-n e partnerët, i hapësirës tokësore, ajrore e detare.

- Kryerja e operacioneve luftarake për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit dhe mbrojtjen e popullsisë.

- Kryerja e operacioneve humanitare në mbështetje të strukturave civile në raste fatkeqësish natyrore dhe katastrofash në mjedis.

- Kryerja e operacioneve të kërkim - shpëtimit në tokë dhe në det.

- Ushtrimi i ligjshmërisë në ujërat territoriale nëpërmjet Rojës Bregdetare në bashkëpunim me institucionet e tjera që kanë interesa në det.

- Kryerja e stërvitjeve brenda vendit dhe pjesëmarrja në ato jashtë vendit për ruajtjen e nivelit operacional dhe arritjen e ndërveprimit me forcat e NATO-s dhe ato partnere.

- Krijimi dhe përgatitja e kapaciteteve operacionale për pjesëmarrje në luftën kundër terrorizmit.

- Pjesëmarrja në Operacionet e Mbështetjes së Paqes.

- Sigurimi i ndërveprueshmërisë së strukturave të saj, si dhe bashkërendimi e inkuadrimi i masave tona mbrojtëse me ato të vendeve partnere në kuadrin e një mbrojtjeje kolektive (rajonale).

- Zbatimi i masave për parandalimin e dëmtimit të mjedisit dhe menaxhimi e mbrojtja e tij gjatë veprimtarive ushtarake, si dhe ndërmarrja e operacioneve të veçanta për eliminimin e dëmeve në mjedis të shkaktuara nga faktorë të tjerë.

- Mbështetja e strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe e strukturave të tjera civile për ruajtjen e rendit kushtetues, për luftën kundër terrorizmit, trafikëve ilegale dhe parandalimin e trafikut ilegal të armëve konvencionale dhe të ADM.

- Realizimi i detyrimeve që lindin nga pozicioni i vendit pritës (HN) në mbështetje të forcave të NATO-s a të koalicionit, të cilat mund të veprojnë, të stërviten ose të kalojnë nëpër territorin e RSH, krahas lehtësirave portuale dhe aeroportuale.

4.4. Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes përbëhet nga Komanda e Shtabi, Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, Universiteti Ushtarak “Skënderbej”, Akademia e Nënoficerëve “Tomson”, Brigada e Stërvitjes Bazë, Qendra e Analizave të Mbrojtjes, Qendra e Mbështetjes së Stërvitjes dhe Shkolla e Trupës.

Misioni i Komandës së Doktrinës e të Stërvitjes është: arsimimi dhe stërvitja individuale e të gjithë personelit të FA dhe përpunimi i koncepteve doktrinale të përdorimit të tyre.

Detyrat kryesore të Komandës së Doktrinës dhe të Stërvitjes për realizimin e misionit të vet janë:

- Stërvitja bazë e të gjithë ushtarakëve të FA;
- Stërvitja individuale e avancuar dhe aftësi profesional i ushtarëve, nënoficerëve e oficerëve sipas specialiteteve;
- Arsimimi dhe stërvitja e nënoficerëve të FA;
- Arsimimi dhe stërvitja e oficerëve të trupës;
- Arsimimi dhe kualifikimi i oficerëve të shtabit dhe i drejtuesve të lartë ushtarakë e civilë të FA;
- Arsimimi dhe kualifikimi i civilëve të administratës së mbrojtjes;
- Zhvillimi i bazës doktrinale të përbashkët të FA;
- Hartimi i manualeve e rregulloreve të FA;
- Kryerja e studimeve e analizave në fushën e mbrojtjes dhe nxjerrja e mësimave për përgatitjen dhe standardizimin e forcës.
- Pjesëmarrja në stërvitjet e ndryshme të shtabeve dhe trupës, me qëllim vlerësimin/testimin e gjithë procesit të arsimim-stërvitjes dhe koncepteve doktrinale.
- Menaxhimi dhe modernizimi i poligoneve kombëtare të stërvitjes për kontrollin, testimin e certifikimin e njësive operacionale të FA.

4.5. Komanda e Mbështetjes përbëhet nga Komanda e Shtabi, Brigada Logjistike, Regjimenti i Mbështetjes së SHPFA, Regjimenti i Infrastrukturës, Spitali Ushtarak Qendror Universitar, Batalioni i Policisë Ushtarake, Qendra e Zhvillimit të Sistemeve dhe Qendra e Personel – Rekrutimit.

Misioni i Komandës së Mbështetjes është: sigurimi i mbështetjes me personel, logjistikë, infrastrukturë dhe shërbime të Forcave të Armatosura në interes të plotësimit të misionit të tyre kushtetues, mbështetja e strukturave të FA në operacione humanitare dhe në misione ndërkombëtare.

Detyrat kryesore të Komandës së Mbështetjes për realizimin e misionit të vet janë:

- Mbështetja e veprimtarisë dhe e operacioneve të FA me të gjitha klasat e furnizimit, me transport, mirëmbajtje e riparim për pajisjet e mjetet tokësore në nivelin III e IV;
- Mbështetja e FA në kryerjen e operacioneve humanitare për përballimin e emergjencave civile, si dhe mbështetja e autoriteteve civile kur kërkohet prej tyre dhe kur e lejon ligji;
- Mbështetja e FA dhe veçanërisht e MM dhe SHPFA me shërbime komunikimi nëpërmjet rrjeteve e radiatorjeteve të zakonshme e të klasifikuara, si dhe mbrojtja e sigurimi i infrastrukturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm;
- Mbështetja e FA në përmirësimin e zhvillimin e infrastrukturës;
- Sigurimi i mbështetjes gjeografike, rritja e kapaciteteve të shërbimit hartografik kombëtar, si dhe studimi e grumbullimi i të dhënave hapësinore, për krijimin e botimit e hartave gjeografike të hapësirës së RSH, në interes të FA, institucioneve studimore dhe sistemit arsimor;
- Sigurimi i mbështetjes shëndetësore për personelin e FA në kohë paqeje, krize e lufte;
- Sigurimi i plotësimit me personel të strukturave të FA dhe menaxhimi i sistemit të personelit;
- Zhvillimi i kërkesave operacionale dhe kthimi i tyre në standarde, kushte e specifikime teknike. Hartimi i programeve të blerjes dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve;
- Menaxhimi i municioneve dhe i pajisjeve të tepërta, si dhe kryerja e operacioneve për shkatërrimin e tyre dhe pastrimin e rajoneve të infektuara nga eksplozivat.

V. ZHVILLIMI I FORCAVE TË ARMATOSURAS

Zhvillimi i FA është përgjegjësi e udhëheqjes së lartë civile e ushtarake, e cila mbështetet në objektivat dhe parimet e politikës së mbrojtjes për zhvillimin e një force ushtarake të aftë për të garantuar mbrojtjen e vendit. Forca e autorizuar do të ketë një personel jo më shumë se 14 000 vetë, ushtarakë dhe civilë. Ministria e Mbrojtjes mban dhe përditëson një liste të personelit rezervist që mund të aktivizohet në raste situatash emergjente për përballimin e kërcënimeve dhe rreziqeve. Kjo listë nuk kalon 10 mijë vetë, ndërsa aktivizimi i kësaj liste bëhet me akt të veçantë nga Kuvendi i Shqipërisë.

5.1. Krijimi i kapaciteteve mbetet përparësi kryesore e zhvillimit të FA për përgatitjen e tyre

për integrim në strukturat ushtarake të NATO-s. Për këtë qëllim kërkohet që strukturat ushtarake, në mënyrë të mëvetësishme ose në bashkëpunim me aleatët dhe partnerët, të sigurojnë kapacitetet cilësore të mëposhtme:

- Kapacitete për kryerjen e operacioneve ushtarake për mbrojtjen e territorit të RSH, duke vepruar mëvetësisht dhe së bashku me forca aleate e partnere;
- Operacione luftarake fillestare për mbrojtjen e territorit të vendit;
- Kapacitete për sigurimin e mbështetjes së vendit pritës;
- Ndërveprim me forcat aleate dhe partnere.
- Kapacitete për mbështetjen e popullsisë në raste fatkeqësish natyrore dhe krizash humanitare.
- Kapacitete për arritjen e ndërveprueshmërisë me forcat e NATO-s dhe për kryerjen e operacioneve ushtarake jashtë vendit (duke përfshirë edhe operacionet antiterroriste).
- Kapacitete për shkëmbimin e informacionit që lidhet me sigurinë dhe mbrojtjen me NATO-n dhe vendet partnere.
- Kapacitete operacionale për bashkëpunimin civilo-ushtarak.

5.2. Zhvillimi i FA synon krijimin e një force tërësisht profesioniste, duke e kuptuar atë jo vetëm si një forcë të kompletuar 100 për qind me ushtarë me pagesë, por para së gjithash si një cilësi të re. Rritja e kapaciteteve operacionale dhe e ndërveprueshmërisë janë tregues të rëndësishëm të efekteve pozitivë të krijimit të forcës profesioniste. Hedhja e bazave të krijimit të forcës profesioniste bëhet duke u mbështetur në përvojën e vendeve të NATO-s, në mundësitë tona reale, si dhe në mësimet e nxjerra nga pjesëmarrjet e deritanishme në operacione.

5.3. Arsimimi dhe stërvitja e Forcave të Armatosura synojnë në rritjen e nivelit profesional të personelit, rritjen e kapaciteteve operacionale, përmbushjen e standardeve për integrim në NATO, si dhe përmirësimin e aftësive për pjesëmarrje të suksesshme në operacione brenda dhe jashtë vendit.

5.4. Përhapja strategjike synon të sigurojë veprim të shpejtë ndaj çdo situatë, komandim e drejtim të plotë, manovrueshmëri dhe mbështetje logjistike të vazhdueshme, bashkëpunim me partnerët në operacionet e mbështetjes së paqes dhe një shkallë të lartë gatishmërie në menaxhimin e emergjencave civile.

5.5. Forcat e Armatosura të RSH përfshijnë forcat operacionale dhe ato mbështetëse.

Forcat operacionale përfshijnë të gjitha strukturat që përgatiten dhe kryejnë operacione. Ato kërkohet të jenë plotësisht të kompletuara me burimet e nevojshme njerëzore, materiale e financiare dhe të mirëstërvitura, për të kryer operacione brenda vendit, si dhe për të marrë pjesë në operacione jashtë vendit në kuadër të NATO-s, BE-së, OKB-së dhe të koalicioneve të ndryshme.

Repartet dhe njësia e mbështetjes rajonale organizohen për sigurimin e pranisë ushtarake në rajonet përkatëse, për ruajtjen e infrastrukturës kyçe, kur kërkohet, për mbështetjen e strukturave të tjera të FA kur kryejnë operacione në rajonet e tyre të përgjegjësisë, si dhe për mbështetjen e autoriteteve vendore në përballimin e emergjencave civile.

Forcat mbështetëse përfshijnë strukturat që realizojnë arsimimin dhe stërvitjen e personelit të FA, si dhe ato që mbështetnin veprimtarinë e FA me personel, logjistikë, infrastrukturë dhe shërbime.

Njësitë dhe repartet e komponentëve tokësorë, detarë dhe ajrorë inkuadrohen dhe veprojnë në varësi të Komandës së Forcës së Bashkuar. Njësitë dhe repartet mbështetëse inkuadrohen dhe veprojnë në varësi të Komandës së Mbështetjes. Institucionet e arsimimit dhe të stërvitjes inkuadrohen e funksionojnë në varësi të Komandës së Doktrinës dhe të Stërvitjes.

Zhvillimi i FA bëhet duke pasur në qendër të vëmendjes njësitë dhe kapacitetet parësore, të cilat janë edhe kontributi kryesor i FA shqiptare për arritjen e aftësive dhe të ndërveprueshmërisë së kërkuar, si dhe për plotësimin e objektivave të partneritetit dhe integrimin në NATO.

5.6. Krijimi i strukturave të komandimit dhe të kontrollit

Krijimi i strukturave të komandimit dhe të kontrollit të FA bëhet në tre nivele: strategjik, operativ dhe taktik.

Detyrat kryesore të nivelit strategjik të komandimit dhe kontrollit janë:

- Në kohë paqeje: përcaktimi i politikave dhe i përparësive, vlerësimi i rrezikut dhe i kërcënimit, nxjerrja e direktivave dhe e udhëzimeve politike dhe të planifikimit, planifikimi dhe menaxhimi i zhvillimit të forcës, mbështetja me burime e FA, si dhe ushtrimi i komandimit e kontrollit të Forcave të Armatosura.

- Në kohë krize e lufte: përcaktimi i masave dhe i përgjigjeve ndaj krizës në nivel kombëtar, hartimi dhe miratimi i objektivave kombëtarë për përballimin e luftës a të krizës dhe ushtrimi i komandimit të plotë mbi FA.

Detyrat kryesore të nivelit operativ të komandim-kontrollit janë:

- Në kohë paqeje: planifikimi i operacioneve ushtarake, sigurimi i shkallës së kërkuar të gatishmërisë luftarake, stërvitja dhe përgatitja e forcës për operacione ushtarake, planifikimi i përdorimit të FA për realizimin e misionit të tyre, komandimi dhe kontrolli i operacioneve ushtarake.

- Në kohë krize e lufte: komandimi e kontrolli i njësive e reparteve vartëse për arritjen e objektivave ushtarakë.

Detyrat kryesore të nivelit taktik të komandim-kontrollit janë:

- Në kohë paqeje: përgatitja, stërvitja dhe ruajtja e nivelit të kërkuar të gatishmërisë së njësive për përbushjen e objektivave e të detyrave të caktuara dhe për pjesëmarrje në operacionet e paqes.

- Në kohë krize e lufte: arritja e objektivave dhe realizimi i detyrave në përputhje me planet dhe direktivat operative.

Kuvendi i Shqipërisë, Presidenti i Republikës, Kryeministri, Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Mbrojtjes ushtrojnë drejtimin politiko-strategjik, ndërsa Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA ushtron komandimin e drejtimin ushtarako-strategjik të Forcave të Armatosura.

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ushtron kompetencat e tij në fushën e sigurisë nëpërmjet procesit legjislativ duke miratuar ligje dhe ushtruar kontrollin civil demokratik mbi Forcat e Armatosura. Kuvendi ka kompetenca kushtetuese për shpalljen e gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme, për ratifikimin e marrëveshjeve dhe shqyrtimin, menaxhimin e miratimin e buxhetit e të politikave shtetërore të mbrojtjes.

2. Presidenti i Republikës është Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe në kohë paqeje ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa në kohë lufte i drejton Forcat e Armatosura drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet Komandantit të Forcave të Armatosura. Presidenti i Republikës i propozon Parlamentit shpalljen e gjendjes së luftës, të mobilizimit dhe të çmobilizimit. Në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit, Presidenti ndihmohet nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare.

3. Këshilli i Ministrave, si organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv, përgjigjet për zbatimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe gjendjen e zhvillimin e instrumenteve të sigurisë dhe të burimeve të mbrojtjes. Ai i propozon parlamentit projekt-ligje për mbrojtjen, si dhe për funksionimin efektiv të FA.

4. Kryeministri, si funksionari më i lartë i pushtetit ekzekutiv, përgjigjet para Parlamentit dhe Presidentit për drejtimin dhe gjendjen e FA në kohë paqeje. Ai koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të Politikës së Sigurisë dhe siguron bashkërendimin dhe zbatimin e tyre në përputhje me Kushtetutën e ligjet. Kryeministri krijon dhe drejton Komitetin e Politikave të Sigurisë Kombëtare.

5. Ministri i Mbrojtjes përgjigjet para Kuvendit, Presidentit dhe Kryeministrit për formulimin dhe zbatimin e Politikave të Mbrojtjes.

6. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është autoriteti ushtarak më i lartë. Ai është përgjegjës para Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes për zbatimin e Strategjisë Ushtarake dhe komandimin e drejtimin e Forcave të Armatosura. Ai drejton përgatitjen dhe gatishmërinë luftarake të Forcave të Armatosura, siguron plotësimin me personel, si dhe drejton organizimin e veprimeve ushtarake dhe joushtarake.

7. Komandantët e komandave kryesore realizojnë komandimin dhe kontrollin e efektivave të tyre nëpërmjet urdhrave dhe udhëzimeve të karakterit ushtarako-administrativ brenda kompetencave të përcaktuara me ligj.

5.7. Krijimi i rezervave materiale

Rezervat materiale krijohen në funksion të misionit kushtetues të Forcave të Armatosura. Krijimi i rezervave mbështetet në kapacitetet e disponueshme të komandave, në buxhetin e mbrojtjes dhe në burimet kombëtare. Rezervat materiale përdoren gjithashtu për mbështetjen e FA dhe popullsisë civile në përballimin e situatave të jashtëzakonshme që shkaktohen nga forca madhore si tërmete, përmytje, epidemi, ndotje të mjedisit etj., në kohë paqeje, krize dhe lufte.

Forcat e Armatosura evidentojnë burimet kombëtare (publike apo private) në interes të misioneve të tyre dhe në përputhje me legjislacionin përkatës, planëzojnë masa konkrete, për përdorimin e tyre në rast nevojë.

Rezervat materiale përshkallëzohen sipas kriterëve doktrinore dhe misionëve specifike të njësive. Struktura dhe niveli i rezervave materiale, si dhe shkalla e gatishmërisë së tyre propozohen nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave të RSH. Vazhdimësia e rezervave materiale sigurohet nga burimet kombëtare (publike apo private).

VI. BURIMET E MBROJTJES

Burimet e mbrojtjes krijohen dhe menaxhohen në përputhje me misionin e Forcave të Armatosura, duke i dhënë rolin parësor zhvillimit të personelit, si pjesa më e rëndësishme e tyre. Ato zhvillohen duke pasur parasysh ndryshimet strukturore të FA, si dhe në funksion të krijimit të kapaciteteve operacionale reale.

6.1. Burimet njerëzore

Konsolidimi i Sistemit të Përgjithshëm të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe përkujdesja ndaj personelit mbetet një nga detyrat parësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Personeli i FA përfshin ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, personelin ushtarak profesionist dhe personelin civil të punësuar në strukturat e FA. Nëpërmjet transformimit të vijueshëm të FA, synohet që deri në fund të vitit 2010 ato të shndërrohen në një forcë tërësisht profesioniste.

Sistemi i menaxhimit dhe i zhvillimit të burimeve njerëzore ka në qendër të vëmendjes përgatitjen e oficerëve, të nënoficerëve, të ushtarëve profesionistë dhe të personelit civil, të mirësimin dhe të trajnuar me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të shërbyer në detyra brenda dhe jashtë vendit. Ky sistem përfshin menaxhimin e gjithë ciklit jetësor të personelit, që nga identifikimi i nevojave, rekrutimi, arsimimi e trajnimi, mbajtja e personelit në shërbim, trajtimi ekonomiko-financiar, zhvillimi i karrierës e deri në daljen në pension e mbështetjen për integrimin e tij në jetën civile.

Kategoritë kryesore të personelit zhvillohen në mënyrë progresive, duke ruajtur raportin e duhur ndërmjet oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve profesionistë. Kalimi në një forcë tërësisht profesioniste do të arrihet nëpërmjet zbatimit të një plani të detajuar, duke synuar uljen e vazhdueshme të numrit të ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm dhe zëvendësimin e tyre me ushtarë profesionistë, të cilët do të shërbejnë si bazë e mirë edhe për krijimin e një korpusi të konsoliduar nënoficerësh.

Plotësimi i strukturave të FA, sidomos i njësive e reparteve prioritare e që marrin pjesë në misionet ushtarake jashtë vendit, me nënoficerë e ushtarë profesionistë, mbetet përparësi e rëndësishme e menaxhimit të personelit në FA. Politikat dhe strategjitë e rekrutimit, të mbështetura në një marketing bashkëkohor, që promovon vlerat e FA, përfitimet dhe garancitë sociale për personelin dhe familjet e tyre, synojnë në rritjen cilësore të FA.

FA zhvillojnë dhe zbatojnë në vijimësi politika, strategji e programe edhe për mbështetjen sociale të personelit, si: rritjen e mirëqenies; përmirësimin e kushteve të jetesës; kujdesin shëndetësor për ushtarakët dhe familjet e tyre, integrimin e ushtarakëve në shoqëri pas daljes nga radhët e FA etj. Këto masa mbështetin si ushtarakët që janë në shërbim aktiv ashtu edhe ata që dalin në rezervë.

6.2. Burimet materiale

Qeveria e RSH siguron burime materiale të mjaftueshme për zhvillimin dhe transformimin e Forcave të Armatosura, duke u fokusuar në sigurimin e atyre burimeve që shkojnë për krijimin e kapaciteteve operacionale, që i bëjnë FA të afta për kryerjen e misionit të tyre kushtetues dhe të ndërveprueshme me forcat ushtarake të NATO-s. Gjithë burimet materiale që vihen në dispozicion të FA si nëpërmjet prokurimeve nga buxheti i mbrojtjes, ashtu edhe nga ndihmat e aleatëve dhe të partnerëve, synohet të jenë në përputhje me standardet e NATO-s.

Sigurimi i sasisë së mjaftueshme të burimeve të mbrojtjes dhe standardizimi i tyre përfshin të gjitha fushat e mbështetjes logjistike të FA. Armatimi, ushqimi, veshmbathja, karburanti, shërbimet e trupës, transporti dhe mirëmbajtja janë fusha të rëndësishme që mbështeten në mënyrë harmonike me burime materiale. Një ndërthurje efektive e sektorit shtetëror me atë privat siguron burime materiale cilësore dhe në kohën e duhur për mbështetjen e objektivave të mbrojtjes.

6.2.1. Sistemet dhe pajisjet

Koncepti për zhvillimin e sistemeve dhe të pajisjeve të FA do të sigurojë që ato të jenë operacionale e të ndërveprueshme me ato të NATO-s. Në këtë drejtim rëndësi të veçantë merr ngritja dhe mbajtja e kapaciteteve bazë të tilla si: **sistemi C4I, lëvizshmëria, efikasiteti në operacion, qëndrueshmëria dhe ruajtja e forcave, mbështetja logjistike dhe mbështetja e përgjithshme.** Në

kushtet e rritjes progresive të buxhetit të mbrojtjes, mundësohet një investim më i madh në modernizimin e sistemeve dhe të pajisjeve sipas standardeve, në kompletimin me sisteme e pajisje komunikimi, në përmirësimin e sistemit të vëzhgimit të hapësirës ajrore, detare e tokësore, në vijimin e kompletimit me sisteme dhe pajisje të tjera për strukturat prioritare, në krijimin e kapaciteteve operacionale të veçanta për operacione ndërkombëtare në kuadrin e NATO-s etj.

Krahas stërvitjeve në terren, përparësi merr zhvillimi i kapaciteteve të simulimit taktik bashkëkohor për mbështetjen e arsimimit dhe të stërvitjes së komandave e shtabeve. Kapacitetet e simulimit duhet të mbështetin gjithë spektrin e operacioneve të FA, duke përfshirë operacionet shumëkombëshe e të përbashkëta, ato paqeruajtëse, operacionet speciale, mbështetjen ushtarake për emergjencat civile, luftën kundër terrorizmit etj.

6.2.2. Infrastruktura ushtarake

Forcat e Armatosura synojnë të ngrenë dhe të mirëmbajnë një infrastrukturë të mjaftueshme e bashkëkohore. Projektimi, ndërtimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e kësaj infrastrukture siguron kushte të përshtatshme jetese e stërvitjeje për FA dhe funksionim normal të tyre në situatë krizash. Ajo gjithashtu duhet të jetë në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga përmbushja e detyrimeve në kuadër të anëtarësimit në NATO, të cilat përfshijnë pranimin dhe sigurimin e kushteve të ruajtjes e të sigurisë për forcat e Aleancës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Përqendrimi dhe integrimi i garnizoneve kryesore, rikonstruksioni i infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimet e reja, vlerësohen si pjesë e rëndësishme për plotësimin e nevojave të forcës me kushte më cilësore pune, jetese dhe argëtimi. Përparësi merr krijimi i një numri më të vogël, por më të efektshëm garnizonesh, nëpërmjet përqendrimit të bazave, depove e ndërtesave ekzistuese. Synohet që ato të menaxhohen sipas një koncepti të ri dhe të konsolidohen në vazhdimësi, duke nxjerrë nga përdorimi ose duke asgjësuar teknikën, armatimin dhe municionet e tepërta. Infrastruktura që del jashtë planit të përhapjes dhe mbi nevojat e FA do të tjetërsohet sipas ligjeve në fuqi.

Zhvillimi i kapaciteteve të vendit pritës nëpërmjet krijimit rast pas rasti të strukturave të veçanta modul, si dhe i kapaciteteve mbështetëse në Komandën e Mbështetjes, në Aeroportin e Rinasit, në portin e Durrësit etj., përbën një detyrë të rëndësishme të FA në funksion të integritetit të tyre në NATO.

Infrastruktura për jetesë mbetet pjesë e rëndësishme e zhvillimit të infrastrukturës duke synuar përshtatjen dhe modernizimin e asaj ekzistuese dhe ndërtimin e mjediseve të reja në përputhje me standardet e NATO-s për plotësimin e nevojave të personelit. Infrastruktura për jetesë është pjesë e rëndësishme e politikës për t'i bërë Forcat e Armatosura sa më tërheqëse për të rinjtë.

Infrastruktura për punë, arsimim dhe stërvitje synon në ndërtimin e objekteve të reja dhe përshtatjen e atyre ekzistuese sipas normave të NATO-s, me synim përfundimin e tyre në një periudhë afatmesme. Ndërtimi i poligoneve të reja, si dhe rikonstruksioni i atyre ekzistuese synojnë në krijimin e kushteve bashkëkohore për stërvitjen e efektivave.

6.3. Burimet financiare

Burimet financiare për mbështetjen e shpenzimeve të mbrojtjes sigurohen nga buxheti i shtetit dhe nga programet e bashkëpunimit ushtarak.

6.3.1. Buxheti i mbrojtjes dhe rritja e pritshme e tij në periudhën afatmesme

Realizimi i objektivave të Strategjisë Ushtarake për zhvillimin e Forcave të Armatosura është i lidhur ngushtë me sigurimin, shpërndarjen dhe menaxhimin e efektshëm të burimeve financiare. Mbështetja financiare nga buxheti i shtetit synon sigurimin e burimeve të kërkuara për zhvillimin e FA, si dhe përbalimin e kostos së integritetit në strukturat euroatlantike.

Përdorimi i burimeve financiare bëhet në mënyrë të baraspeshuar, për të pasur një zhvillim harmonik e të integruar të të gjitha fushave të mbrojtjes, duke e trajtuar motivimin dhe zhvillimin e personelit si prioritetin më të rëndësishëm të Reformës së Mbrojtjes, por duke u dhënë mbështetjen e duhur edhe fushave të tjera si: infrastruktura, modernizimi i sistemeve dhe i pajisjeve, stërvitja dhe veprimtaritë e përditshme të FA.

Për të siguruar zhvillimin, transformimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura për përmbushjen e objektivave që shtrën kjo strategji, si dhe për t'i bërë ato të përshtatshme për t'u integruar në strukturat ushtarake të NATO-s, buxheti i mbrojtjes do të vazhdojë të rritet duke **arritur**

në 2 për qind të PBB në vitin 2008. Pas këtij viti buxheti i mbrojtjes do të synojë të ruajë këtë nivel ndaj PPB (2 për qind) deri në vitin 2020.

Ndarja e fondeve synon arritjen e standardeve të NATO-s, duke mbajtur parasysh uljen graduale të përqindjes që zënë shpenzimet për personelin dhe rritjen graduale të shpenzimeve operacionale e të mirëmbajtjes; rritjen e shpenzimeve për modernizimin e sistemeve e të pajisjeve dhe uljen e shpenzimeve për infrastrukturën.

Përparësitë në menaxhimin e burimeve financiare do të jenë:

1. Për periudhën deri në marrjen e ftesës për anëtarësim, rëndësi do t'i kushtohet mbështetjes financiare të transformimit të FA në një forcë profesioniste, krijimit të kapaciteteve të ndërveprueshme me NATO-n, kryesisht elementeve të C4I, si dhe implementimit të Objektivave të Partneritetit.

2. Për periudhën nga marrja e ftesës deri në anëtarësimin e plotë në NATO, mbështetja financiare për forcën profesioniste do të vijojë të jetë përparësi e rëndësishme, e ndërthurur me mbështetjen për rritjen e kapaciteteve operacionale të ndërveprueshme e të dislokueshme, si dhe me krijimin e infrastrukturës së vendit pritës.

3. Për periudhën e pasanëtarësimit, përparësi kryesore për mbështetjen financiare do të ketë përballimi i kostos së integrimit dhe vijimi i mbështetjes së personelit dhe të modernizimit të FA.

6.3.2. Mbështetja në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak

Shqipëria mirëpret çdo ndihmë të vendeve aleate e partnere, duke e integruar atë në sistemin e menaxhimit të burimeve financiare dhe duke e orientuar në mbështetjen e atyre fushave që përbëjnë përparësi të integrimit në NATO.

6.4. Planifikimi i burimeve të mbrojtjes

6.4.1. Sistemi i Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes

Rritja e vazhdueshme e buxhetit të mbrojtjes do të rezultojë në rritjen e përgjegjësisë për një përdorim të kontrolluar dhe të efektshëm të këtij buxheti. Këtij qëllimi do t'i shërbejë planifikimi sa më real e modern i burimeve të mbrojtjes. Objektivi kryesor i planifikimit të burimeve të mbrojtjes do të jetë siguri i kapaciteteve operacionale të kërkuara nga FA për realizimin e misionit të tyre, si dhe mundësi i përdorimit me efektivitet të burimeve të disponueshme. Mekanizmi kryesor i menaxhimit të burimeve të mbrojtjes është Sistemi i Planifikimit, Programimit, Buxhetimit dhe Ekzekutimit (SPPBE), i cili tashmë përdoret në të gjitha strukturat e FA në përputhje me parimet e planifikimit të vendeve të NATO-s. Përsosja e vazhdueshme e tij do të jetë detyrë e rëndësishme për Forcat e Armatosura.

Planifikimi i burimeve të mbrojtjes bashkërendohet në të gjitha nivelet me sistemin e planifikimit të mbrojtjes të përdorur nga NATO. Përpara marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO, ky bashkërendim bëhet nëpërmjet Procesit të Planifikimit dhe të Rishikimit (PARP).

Në nivelin strategjik, planifikimi konsiston në planet dhe programet afatgjata, të cilat projektojnë "forcën objektive" të së ardhmes, si dhe parashikojnë nevojat e përparësitë kryesore të zhvillimit të FA.

6.4.2. Integrimi i Sistemit të PPBES me Sistemin e Planifikimit të Integruar të Qeverisë.

Sistemi i Planifikimit, Programimit, Buxhetimit dhe Ekzekutimit (PPBES) harmonizohet me Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI) të Qeverisë. Ky sistem do t'i shërbejë më mirë punës për bashkërendimin e programeve me burimet dhe do të mundësojë një vendimmarrje të bazuar të Qeverisë për buxhetin e mbrojtjes.

VII. PËRFUNDIME

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë është ripunuar duke pasqyruar ndryshimet në mjedisin e brendshëm dhe në atë rajonal e global të sigurisë. Duke vlerësuar këtë mjedis, ajo parashikon objektivat për përballimin e kërcënimeve potenciale të pritshme.

Strategjia Ushtarake përcakton detyrat për Forcat e Armatosura në tërësi, duke u fokusuar **në arritjen e profesionalizmit të plotë të forcës brenda vitit 2010, në zhvillimin e kapaciteteve operacionale reale, si dhe në përmbushjen e detyrimeve të integrimit në NATO.** Ajo siguron gjithashtu udhëzime për çështjet operacionale, programet e menaxhimit të forcës për përballimin e sfidave të së ardhmes, si dhe jep rekomandime për veprimet e domosdoshme për pakësimin e rreziqeve dhe të kërcënimeve.

Zbatimi i Strategjisë Ushtarake do të mbështetet nga zhvillimi i planeve dhe i programeve të cilat do të çojnë në krijimin e një force të bashkuar, me kapacitete ushtarake reale, të aftë për

përmbushjen e misionit të vet kushtetues për mbrojtjen e vendit dhe për të kontribuar denjësisht në operacione shumëkombëshe në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së. Krijimi një force të tillë do të kërkojë mbi të gjitha njerëz të përkushtuar, profesionalisht të përgatitur, të gatshëm për të shërbyer në FA, të mirarsimuar, të mirëstërvitur e të mirudhëhequr.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 21.1.2008
Doli nga shtypi më 21.1.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2008

Çmimi 32 lekë